ArtEd

Rritemi përmes
Artit në Arsimim

Growing through
Arts in Education

Fuqizimi i 20 Klubeve Teatrore
në Shkollat Kampione

Strengthening 20 Theatre Clubs
in Champion Schools

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by:
giz

In cooperation with:
artpolis art and community center

"Ky projekt organizohet nga Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet, me përkrahjen e GIZ Kosovo në emër të Qeverisë Gjermane"

ArtEd – Fuqizimi i 20 klubeve teatrore në shkollat kampione të Kosovës

22.06.2021 - 22.12.2021
Ky projekt organizohet nga Artpolis - Qendra për Art dhe Komunitet, me përkrahjen e
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

@GIZ Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Artpolis – Qendra për Art dhe Komunitet

Artpolisi është organizatë joqeveritare që vepron në Kosovë dhe promovon kulturën, artin dhe bashkëjetesën multietnike përmes dialogut shoqëror dhe aplikimit të teatrit si mjet për të promovuar zhvillimin social dhe kulturor. E themeluar më 2004, misioni i saj kryesor është të ndikojë në zhvillimin e një shoqërie e cila respekton vlerat kulturore të artit, kulturës dhe diversitetit shoqëror. Përmbysja e sistemit patriarkal duke fuqizuar gratë, të rinjtë e të rejat përmes edukimit jo-formal e duke shtyrë përpara feminizmin dhe vlerat përkatëse janë një prej shtyllave të strategjisë së Artpolis.

Si jemi rritë në 2021?

Ngritje, përforcim, burim dhe vlerë e shtuar për shoqërinë tonë

Në fillim të vitit 2021 Artpolis themeloi trupën artistike rezidente, e para e pavarur e këtij lloji në Kosovë dhe rajon. Trupa e cila përbëhet nga 8 artistë/e profesionistë, 1 koreograf dhe natyrisht edhe regjisorja e kësaj trupe që është edhe themeluesja dhe drejtorja ekzekutive e Artpolis, Zana Hoxha. Tani dy entitetet që e përbëjnë Artpolis: stafi implementues i projekteve dhe aktiviteteve dhe trupa rezidente artistike, kanë një mision të përbashkët që përmes artit e kulturës, në veçanti përmes teatrit të jenë sa më afër publikut duke promovuar dhe mbështetur të drejtat e njeriut.

Si ndikojmë në shoqëri?

Inspirim, fuqizim, vetëdijesim, edukim

Artpolisi ka identitet dhe profil të qartë në spektrin e shoqërisë civile si organizatë e cila me punën e saj në mënyrë sistematike adreson çështje të të drejtave të njeriut, siç është barazia gjinore, fuqizimi i gruas, mbrojtja e grupeve pakicë apo të margjinalizuara si dhe përhapja e feminizmit si vlerë shoqërore.

Me rritjen e përvojës së Artpolis janë rritur edhe aktivitet e pjesëmarrësit/et në to, duke rritur kështu ndikimin në shoqëri, por edhe vlerën e organizatës.

Në mesin e shumë projekteve dhe aktiviteteve të rëndësishme e që janë gjithmonë në vijë me strategjinë e Artpolis ishte edhe krijimi i Klubeve Teatrore në 20 shkollat kampione në vitin 2020, e fuqizimi i tyre në vitin 2021. Por krijimi i klubeve nuk u bë vetëm nëpër këto shkolla, Artpolis dhe trupa rezidente ka punuar intenzivisht edhe me qendra tjera, me qëllimin e vetëm: të inkuadrohen sa më shumë të rinj e të reja të të gjitha komuniteteve që jetojnë nëpër këto qendra, në adresimin e çështjeve dhe dukurive negative gjithmonë duke aplikuar artin, përkatësisht teatrin.

ArtEd – Rritemi përmes Artit në Arsimim

Fuqizimi i 20 klubeve teatrore në shkollat kampione

Përmes projektit “ArtEd - Rritemi përmes artit në arsimim – Fuqizimi i 20 klubeve teatrore në shkollat kampione” Artpolis ka fuqizuar të rinjtë e të rejat në 20 shkolla kampione në shtatë Komuna të Kosovës. Përmes kapaciteteve të ngritura Klubet Teatrore janë pavarësuar për të mbështetur gjeneratat e reja të të rinjve të shkollave, e për të prodhuar art të mirëfilltë. Të drejtat e njeriut dhe mirëqenia e nxënësve janë vënë në pah përmes këtij mësimi jo-formal përderisa në këtë mënyrë janë informuar dhe janë integruar në kërkesat e tyre edhe palët e interesit: donatorët, partnerët, shkollat, prindërit, nxënësit e publiku i gjerë në rrjetet sociale.

Përmes këtyre aktiviteteve joformale Artpolis ka synuar t’iu ofrojë nxënësve një platformë për të shprehur veten, për të nxitur debat, për të rritur vetëdijen, për të zhvilluar mendimin kritik e për t’iu dhënë nxënësve një përvojë të paharruar në të gjitha trajnimet e projektit, duke kulmuar me prezantimet e shfaqjeve forum teatër para publikut të gjerë.

Objektivat:

Fuqizimi i 20 klubeve teatrore në shkollat kampione

Promovimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirja e të nxënit përmes aktiviteteve joformale dhe jashtëshkollore

Nxitja e krijimtarisë, të menduarit kritik dhe e vetëvlerësimit të nxënësve përmes klubeve teatrore brenda mjedisit të shkollës.

Trajtimi i fenomeneve negative të shkollës dhe reflektimeve për përqafimin e diversitetit, barazisë dhe kohezionit social përmes metodave të të nxënit ndërveprues.

Rritja e përfshirjes së prindërve dhe përmirësimi i mjedisit shkollor përmes ngritjes së kapaciteteve dhe pajisjeve të nevojshme të klubeve teatrore.

Aktivitetet:

Kampi Artistik 03-06 korrik 2021: 20 nxënës/e të shkollave kampione u bënë bashkë dhe u trajnuan nga 10 aktorë profesionistë, në Kampin Artistik në Etno Kompleksin në Kukaj, për tu bë liderë të klubeve të tyre në 20 shkollat kampione.

Punëtoria online për dramaturgji 22-25 shtator 2021: 42 nxënës të shkollave kampione kanë ndjekur këtë trajnim online nën mentorimin e dramaturgëve të njohur Fadil Hysaj dhe Visar Krusha.

Klubet teatrore, trajnimet dhe provat: Klubet teatrore tashmë të themeluara nga Artpolis në vitin 2020, u rifreskuan me nxënës të rinj në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe drejtorët/et e shkollave. Ata u njoftuan me trajnerët e tyre dhe vazhduan punën në ambientet shkollore, nën mentorimin e aktorëve profesionistë: Qendresa Kajtazi, Kushtrim Qerimi, Edlir Gashi, Armend Zeqiri, Daniela Markaj, Armend Ballazhi e Flamur Ahmeti.

Shfaqjet Forum Teatër: Pas procesit disa javor të provave nga data 26 tetor, 2021 ka filluar edhe prezantimi i shfaqjeve forum teatër në ambiente të shkollave, por edhe në Teatro të Qyteteve, Shtëpive të Kulturës e Qendra Rinore, për t'u përmbyllur me katër shfaqje në Teatrin e Qytetit "Hadi Shehu" në Gjakovë më 30 nëntor.

Xhirimi dhe editimi i shfaqjeve forum teatër: Të gjitha shfaqjet teatrore janë xhiruar dhe edituar në mënyrë profesionale, përfshirë edhe diskutimin me publikun, për t'u publikuar më pas në uebfaqe dhe ne Facebook, për të garuar në edicionin e nëntë të Festivalit Teatri për të Rinj/Reja 2021.

Festivali i Teatrit për të Rinj/Reja, Edicioni 9-të (online) 10.12.2021-12.12.2021: Në këtë festival janë përzgjedhur pesë shfaqjet më të mira që kanë konsistuar me çmimin e publikut, dhe tre vendet e para që janë përzgjedhur nga juria profesionale në përbërje të: Anisa Ismailit, Dardan Kryeziut e Visar Krushës.

Sfidat që u tejkaluan**:** Përveç kënaqësisë së punës me nxënës dhe momenteve të bukura të krijuara përgjatë aktiviteteve, si dhe rezultateve të shkëlqyera, e gjithë kjo punë i ka pasur edhe disa sfida. Ndër sfidat më të mëdha edhe sivjet ka qenë përballja me pandeminë Covid-19, që ndikoi direkt në punën me klubet teatrore, për shkak të fillimit mësimor me vonesë e që rrjedhimisht shkaktoi shkurtimin e kohës së implementimit; Po ashtu mungesa e hapësirave adekuate për zhvillimin e provave dhe prezantimin e shfaqjeve në disa shkolla si dhe përplasja e orareve të nxënësve me aktivitetet jashtë shkollore, ishin barriera tjera që duhej të tejkaloheshin. Të gjitha këto bënë që stafi implementues të angazhohet më shumë në gjetjen e zgjidhjeve, respektivisht hapësirave të përshtatshme për prova dhe shfaqje, e që rezultoi me bashkëpunime të reja me institucionet lokale të qendrave përkatëse.

Rezultatet:

20 nxënës të klubeve teatrore kanë vijuar trajnime, argëtim, lojëra, meditim dhe në fund edhe certifikim së bashku me 10 artistë profesionistë në ambientet e bukura të Etno Kompleksit të fshatit Kukaj.
42 nxënës kanë vijuar Punëtorinë Online për Dramaturgji nën mentorimin e dramaturgëve të njohur, prof. Fadil Hysaj dhe Visar Krusha dhe më pas u certifikuan.
229 nxënës janë përfshi në krijimin e shfaqjeve.
22 mësimdhënës janë përfshi dhe kanë ndihmuar në krijimin e shfaqjeve.
20 Shfaqje Forum Teatër janë krijuar, prezantuar dhe xhiruar para publikut divers.
10 shkolla kane qenë nikoqire të shfaqjeve të tyre forum teatër.
5 shfaqje janë prezantuar në skenat e teatrove të qyteteve përkatëse.
3 shfaqje në qendra rinore të qyteteve përkatëse.
2 shfaqje në Shtëpi të kulturës.
20 Shfaqje Forum Teatër kanë qenë pjesë e Festivalit të Teatrit për të Rinj/Reja.
5 shfaqje janë përzgjedhë fituese të festivalit.
1190 numri i përfshirë i publikut fizikisht.
65,474 numri i përfshirë i publikut virtual.

Pse Forum Teatri në shkollat kampione?

Forum Teatri është shprehje artistike teatrore që inkurajon ndërveprimin e publikut me personazhet e shfaqjes, si një formë për të vënë në pah dilema të ndjeshme në një mjedis të sigurt përmes debatit, me qëllimin për të arritur transformimin shoqëror në aspektin pozitiv, e duke sfiduar normat shoqërore që pengojnë zhvillimin e shoqërisë. Përmes trajtimit të temave të ndjeshme publiku e personazhet vihen përballë njëri-tjetrit për të diskutuar rreth sjelljeve e veprimeve të aktorëve të luajtura në shfaqje.

Forum Teatri përdoret shpesh nga dhe për grupet e margjinalizuara, si mënyrë për të luftuar shtypjen, padrejtësitë e sfidat me të cilat këto grupe përballen në përditshmëri.

Përmes 20 shfaqjeve forum teatër të realizuara nga Artpolis me shkollat kampione dhe temave të trajtuara në to janë sfiduar normat shoqërore, mendësia patriarkale e dallimet socio-ekonomike, kulturore e politike. Njëherësh, procesi i krijimit të shfaqjeve forum teatër ka shërbyer për ngritjen emocionale, shpirtërore e intelektuale të nxënësve pjesëmarrës, për të cilët ka qenë një hapësirë për të shprehur mendimet, ndjenjat, e problemet me të cilat përballen, duke ofruar për publikun një dimension tjetër të talentit të tyre.

Si u fuqizuan Klubet Teatrore?

1. Kampi Artistik në fshatin Kukaj - Fuqizimi i liderëve të klubeve teatrore

Fuqizimi i Klubeve Teatrore të 20 shkollave kampione nisi më 3 korrik, 2021 në Kampin Artistik që u mbajt deri më 6 korrik në Etno Kompleksin në Kukaj.

Dhjetë aktorë/e profesionistë/e për katër ditë me radhë kanë punuar me 20 nxënës/e liderë/e të shkollave kampione, u bënë bashkë për të realizuar një sërë aktivitetesh të ndërlidhura me teatrin, nën organizimin e stafit të Artpolis.

Për këtë kohë të mbushur me aktivitete nxënësit dhe aktorët/et e Trupës Artistike Rezidente të Artpolis: **Mikel Markaj, Kaltrinë Zeneli, Edlir Gashi, Qendresa Kajtazi, Ismail Kasumi, Blerta Gubetini, Zhaneta Xhemajli, Donikë Ahmeti, Daniela Markaj dhe Art Pasha** shkëmbyen përvoja e bashkëvepruan për të arritur një ngritje profesionale, emocionale e humane. Ndërsa nxënësit që ishin pjesëmarrës në kamp: **Rigon Gashi, Narron Petrovci, Albulena Krasniqi, Erblina Luma, Orkidea Jashanica, Meris Gubetini, Nuela Rrahmani, Yll Pllana, Alteo Ibrahimi, Suhejla Shkodra, Leona Shtufi, Lionit Rashkaj, Pranvera Era Zeqiri, Leart Mustafa, Feab Shabani, Leona Berisha, Sara Deda, Getuar Rexhaj.**

Pas akomodimit në hapësirat e Etno Kompleksit në Kukaj nxënësit, trajnerët e stafi i Artpolis patën rastin të prezantohen e të njihen me njëri-tjetrin. Trajnimi nisi me ushtrime të lehta fizike, për të vazhduar me ndarjen në 5 grupe, të cilët më pas janë angazhuar në krijimin e shfaqjeve, shkrimin e tyre dhe zhvillimin e personazheve, për t'i prezantuar ato po ato ditë, e për të vazhduar punën ende në po të njëjtat shfaqje. Të impresionuar me njëri-tjetrin, nxënësit me aktorët/et e njohur dhe në anën tjetër aktorët/et me vullnetin dhe energjinë e nxënësve. Inspiruar nga natyra që e rrethonte këtë ambient jashtëzakonisht të bukur dhe shumë interesant, ditët u përmbushën me shumë aktivitete.

Ecjet në kodër dhe ushtrimet fizike, të frymëmarrjes, të zërit, meditimit, pastaj trajnimi i ballafaqimit me realitetin, momentit të së vërtetës përmes kalimit të vijës imagjinare e të vendosur barabartë nxënësit dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë që donin të ishin pjesë e lojës duke u përballë me të vërtetën e tyre – njohjen e vetes.

> “Kam marrë shumë gjëra nga nxënësit, sidomos në ushtrimin që e kemi bërë ‘ta kalojmë vijën’, me ç’rast ne bëjmë pyetje dhe fëmijët përgjigjen. Asnjëri nuk është i njëjtë, secili ka personalitet e karakter tjetër dhe kemi mësuar se nuk bën të paragjykojmë e duhet të mundohemi ta kuptojmë se pse ai/ajo po sillet kështu”, **Kaltrinë Zeneli, aktore/trajnere**.

Kampin e kanë vizituar edhe prindër të disa nxënësve, të cilët kanë ardhur t’i shohin fëmijët e tyre se si po kalojnë dhe të shohin ambientin dhe punën që po bëhet me ta. E kur jemi te vizitat në kamp janë përfshirë edhe fëmijë të fshatit Kukaj, të cilët kanë bërë ushtrime të ndryshme me aktoren Qendresa Kajtazi. Mbrëmjet ishin më shumë argëtuese dhe të lira për të gjithë pjesëmarrësit por edhe mundësi për shoqërim relaksues, përmes lojës së zhvilluar të shokut sekret ku janë ndarë shumë dhurata e mesazhe të bukura, por edhe përmes festimit të ditëlindjes që i ishte bërë befasi njërës nga trajnerët Qendresa Kajtazit.

Në fund të trajnimit nxënësit/et janë certifikuar për ndjekjen e suksesshme të trajnimit dhe janë zotuar se do të angazhohen edhe në Klubet Teatrore në shkollat e tyre me njohuritë që i kanë marrë përgjatë këtij Kampi Artistik.

Këto aktivitete kanë marrë edhe vëmendjen e mediave, të cilat kanë ardhur në Kamp për të bërë storie rreth krijimit të shfaqjeve me nxënësit.

2. Trajnimi online për dramaturgji

Çka është drama, cilat elemente e përbëjnë atë, cilat janë zhanret e saj, si të shkruhet e të inskenohet një dramë, si të zhvillohet ngjarja e si të ndërtohen karakteret brenda saj, ishin vetëm disa nga ligjërimet e dramaturgëve prof. Fadil Hysaj dhe Visar Krusha në "Trajnimin Online për Dramaturgji" të mbajtur më 22-25 shtator, 2021.

Mbi 40 nxënës, të ndarë në katër grupe, mësuan elementet bazike të dramaturgjisë, për dramën, tragjedinë, komedinë; duke marrë shembuj të situatave verbale dhe joverbale, të rëndësisë së konfliktit e zgjidhjet kreative që duhet të bëhen në secilën zhanër.

Gjatë këtyre sesioneve përveç ligjërimit teorik për nxënësit, ata/ato patën rastin ta shprehin talentin e tyre në shkrim duke sjellë dramat e tyre para mentorëve prof. Fadil Hysaj e Visar Krusha.

Ky trajnim njëherësh iu ndihmoi nxënësve që njohuritë bazike të fituara t'i vënë në punë gjatë krijimit të shfaqjeve teatrore me klubet e tyre përkatëse dhe të ndërtojnë në krijimin e skenave, ndërtimin e personazheve e ngjarjeve të ndryshme. Më pas 42 nxënës u certifikuan për vijimin e suksesshëm të trajnimit online.



Nxënësit e certifikuar në trajnimin online për dramaturgji: **Rigon Gashi, Melos Krasniqi, Artesa Lezi, Elda Nuredini, Vesa Berisha, Aneta Makolli, Erblina Luma, Teah Kastrati, Arjana Pepaj, Getuar Rexha, Leona Shtufi, Stina Berisha, Dirina Vërshefci, Loresa Sylejmani, Rona Llugaliu, Dijar Gubetini, Lea Zeneli, Arlind Rrahmani, Yll Pllana, Buna Hashani, Mifeta Buhiqi, Erda Mehmeti, Kamila Aliu, Suhejla Shkodra, Erisa Gubetini, Ron Bajoku, Lionit Rashkaj, Ndriçim Rashkaj, Resul Bungu, Pranvera Era Zeqiri, Erblin Muharremi, Leart Mustafa, Lirëza Tabaku, Vlera Mrasori, Sara Gashi, Nurjeta Islami, Gojart Byci, Feab Shabani, Leona Koci, Olta Hereqi, Arrita Zhubi, Sara Deda.**

3. Vlerësimi i nxënësve për trajnimin online

Bazuar në takimet online por edhe nga vlerësimet me shkrim të nxënësve, trajnimi ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve të klubeve por edhe të vetë pjesëmarrësve. Gjatë takimeve ata treguan interes dhe dhanë ide të ndryshme rreth temave. Këto njohuri të marra gjatë trajnimit u përdoren në klubet e tyre, ku ndihmuan në krijimin e tekstit për shfaqjet që u zhvilluan.





Në mesin e shumë teksteve të shkruara nga nxënësit, i veçuam këto:

Romani

Në një bibliotekë në qytetin tim punonte një njeri shumë i mirë, por ishte afër pensionimit, poashtu ai ishte edhe i sëmurë dhe nuk kishte për të jetuar edhe gjatë, tek e fundit kjo është ajo që ai e mendonte. Kishte një ide që të shkruajë një roman për mbesën e tij që pritej së shpejti të vinte në jetë.

Kanë kaluar disa vite dhe më në fund romani është gati, por jeta e plakut po harxhohej, ndërkohë që vajza e tij e thërret atë në telefon.

Vajza: Alo, babi si je?!
Plaku: Mirë vajza ime, kam edhe disa lajme për ty. Romanin që ta kam premtuar e përfundova por shëndeti po më lë, s'po ndihem mirë..! Romanin mund të vish ta marrësh tani edhe dua të të shoh!
Vajza: Mirë babi do të vij tani, faleminderit të dua shumë!

Vajza mbërriti tek babai i saj.

Babi: Mirë se vjen vajza ime!
Vajza: Mirë se të gjeta babi!
Plaku: Mere romanin, deri në moshën 7 vjeçare mos ia jep asaj. Kur ka nevojë ta lexojë edhe nëse unë nuk jam më, kur ajo është duke lexuar këtë libër do ta ndjejë praninë time, do të ndihet mirë, çdo ditë nga një fletë ajo do të lexojë.

Vajza shpërtheu në lot.

Vajza: Të premtoj se këtë do t'ia them, të premtoj babi im i dashur!

Kaloi kohë dhe plaku ndërroi jetë dhe vajza u lind. Vajza e porsalindur nuk e pat shansin që të takojë gjyshin e saj të dashur, vetëm kishte një roman të gjatë që gjithë jetën e saj do ta kujtonte atë!

Nurjeta Islami, SHFMU "Zekeria Rexha", Gjakovë

Letra që e hedh

(Në park, një plak po e shikonte Laurën, një vajzë e re që po dëgjonte muzikë kur papritmas hodhi në tokë letrën e ushqimit që po e hante)

Laura: *(pasi hedh letrën ulet, duke mos vërejtur plakun afër saj)*
PLAKU: Oj çikë! Çikë! *(pasi s'merr përgjigje, ia heq kufjet nga veshët dhe i mban në dorë)*
LAURA: *(zemërohet, me zë të lartë)* Axhë bree, veç sa ke pjesa ma e mirë e kangës, po kthemi dëgjueset!
PLAKU: Çka janë këto, bijë?
LAURA *(rrotullon sytë, shfryhet)* Jon... kufje bre axhë, që ngon muzikë. Po kthemi tash se kesh t'u e ngu ni kang!
PLAKU: Aha, po merri.. Po pse e gjujte atë letër n'tokë ma herët?
LAURA: Cilën letër?
PLAKU: T'tostit që e hangre.
LAURA: *(qeshet)* Po a hala për atë letër je t'u menu a? Unë kom harru që e kam gjujtë, o njeri!
PLAKU: Ehh mori çikë! Me ditë ti, që bota s'ka kohë, se akulli po shkrihet! Që për shkak t'letrave që i gjunë ti, i rrezikon fëmijët e tu ni ditë.
LAURA: *(e shikon)* S'po t'kuptoj o axhë.
PLAKU: Ki me kuptu, mos ki dert. Ki me kuptu kur ti merr uji qytetet e botës, kur fëmijët e tu duhet me shku me maska n'shkollë për mos me vujtë prej sëmundjeve t'mushknive. Atëherë kur ka me qene tepër nxehtë jashtë, për me mujtë me dal qysh del ti sot. Po atëherë ka me qenë vonë. *(pushim)* Leja fëmijës tënd ni trashëgimi t'mirë, jo ni botë ku s'mundet me marrë frymë.

(Plaku e lë letrën mbi ulëse dhe largohet. Pas pak, kthen kokën dhe sheh Laurën e cila ishte ndalur dhe po mendonte. Pastaj, letrën e saj dhe disa letra të tjera në tokë, i hedh në shportë. Plaku buzëqesh dhe largohet.)

Erblina Luma, SHFMU "Xhemail Mustafa", Prishtinë

ArtEd
Certificate
ArtEd
Certificate

Art
Ed
22.06
22.12
2021

Comodita
Comodita
ArtEd
Certificate

4. Provat me Klubet Teatrore dhe prezantimet e shfaqjeve Forum Teatër

Pritjes së gjatë më në fund i kishte ardhur fundi. Pas fillimit të vitit shkollor dhe riaktivizimit të klubeve teatrore në Viber më 10 tetor kanë nisur edhe takimet e para dhe koordinimi për mbajtjen e provave, ndërtimit të personazheve, shkrimit të tekstit e krijimit të shfaqjeve dhe prezantimit të tyre para publikut.

Shtatë aktorë profesionistë: Qendresa Kajtazi, Kushtrim Qerimi, Edlir Gashi, Armend Zeqiri, Daniela Markaj, Armend Ballazhi e Flamur Ahmeti, janë angazhuar që të punojnë me nxënësit e Klubeve Teatrore për krijimin e shfaqjeve.

Pas disa javë të provave, prezantimi i shfaqjeve ka nisur me premierën e shfaqjes së shkollës kampione SHFMU "Xhemail Mustafa", në Prishtinë më 26 tetor në korridorin e kësaj shkolle. Për të vazhduar më pas edhe me dy premiera të tjera në muajin tetor, atë të shkollës "Dr. Ibrahim Rugova" nga Obiliqi më 27 tetor, dhe "Pjetër Bogdani" nga Prishtina, e cila u dha premierë në Amfiteatrin e Fakultetit të Arteve në Universitetin e Prishtinës më 28 tetor. Kurse në nëntor u realizuan 17 shfaqjet forum teatër të shkollave kampione, disa prej tyre në ambiente të shkollës, e disa në Teatro të Qytetit, Shtëpi të Kulturës apo Qendra Rinore. + 9.1- 9.5 (prova me trajnerë)

Stafi i Artpolis, i angazhuar edhe në organizim, gjithashtu ka shikuar e ndjekur nga afër procesin e provave, derisa vlen të theksohet se secila shfaqje është shikuar dhe vlerësuar nga drejtorja e Artpolis dhe regjisorja, Zana Hoxha, e cila ka këshilluar nxënësit e trajnerët për t'i bërë ndryshimet e nevojshme që shfaqja të dalë sa më mirë para publikut.

Blerja e kostumeve dhe rekuizitave për shfaqjet ishte një proces i vazhdueshëm, dhe në bashkëpunim me shkollat disa prej kostumeve janë shpërndarë për shkollat edhe për prezantimin e shfaqjeve, e disave u janë shpërndarë kostumet pas premierave të shfaqjeve.

Prezantimi i shfaqjeve do të ishte i mangët pa një bashkëpunim të ngushtë me shkollat, por edhe me institucione të tjera kulturore, përfshirë këtu: Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, Qendra Rinore në Ortakoll të Prizrenit, Qendra Rinore "Social Hub" në Gjilan, Shtëpia e Kulturës në Shtime, Teatri i Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë dhe Teatri i Qytetit "Hadi Shehu" në Gjakovë".

Për t'i arkivuar, por edhe për t'i përdorur për Festivalin e Teatrit për të Rinj/Reja këto shfaqje forum teatër janë xhiruar dhe kanë garuar ndërmjet veti në edicionin e nëntë të festivalit të mbajtur online.

1. Klubi teatror i shkollës kampione SHFMU “Xhemail Mustafa”, Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër “Ekspozita”

“Një ekspozitë. Shumë njerëz. Çfarë do të ndodhë kur të gjithë këta bien ndesh me njëri-tjetrin? Shfaqja synon të trajtojë ndikimin dhe pasojat e mësimit online, si dhe të sjellë mendimet rreth kësaj çështjeje nga tri këndvështrime: nga ai i nxënësve, i mësimdhënësve dhe i prindërve. A dallojnë këto perspektiva? Si dhe pse ndryshojnë ato nga njëra-tjetra? Të intervistuarit e ekspozitës do të iu përgjigjen këtyre pyetjeve, secili në mënyrën e vet.”

2. Klubit teatror i shkollës kampione SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova”, Obiliq

Shfaqa Forum Teatër “ Të vendosur”

“Në shkollë organizohet një garë për talentët e rinj. Mësuesit zgjedhin disa nxënës për të marrë pjesë në gara për pikturë dhe këndim. Mbajtja e provave do të vështirësohet kur dy djem do të pengojnë procesin duke i shantazhuar dhe bullizuar ata.”

3. Klubit teatror i shkollës kampione SHFMU “Pjetër Bogdani”, Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër “Një ditë në shkollën tonë”

“Një ditë e shkollës sonë është si çdo ditë e të gjitha shkollave, me mësime, angazhime, të qeshura, lojëra, por edhe me hidhërime e të qara. Tema e shfaqjes është bullizmi dhe mënyra se si të rinjtë përballen me këtë dukuri negative të shoqërisë. Ata kalojnë nëpër sfida të shumta, nëpër të cilat mësojnë se si t’i bëjnë ballë fjalëve fyese.”

4. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, Prizren

Shfaqja Forum Teatër “Jemi të barabartë”

“Dy nxënëse të reja ndërrojnë vendbanim nga fshati në qytet. Ditën e parë të shkollës e presin me padurim, përderisa ato do të diskriminohen dhe paragjykohen nga dy nxënës të klasës së tyre.”

5. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren

Shfaqja Forum Teatër “Ti nuk je vetëm”

“Nganjëherë detyrohemi të bëjmë gjëra që s’na pëlqejnë. Kështu ndodhi me dy nxënës të cilët u detyruan të braktisin shkollën për shkak të gjendjes jo të mirë financiare. Kohën që duhej të ishin në shkollë e kalonin në rrugë duke shitur gjësende, edhe pse në moshë jo madhore. Por, shokët e shoqet janë ata që aktivizohen për të ndihmuar.”

6. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Shkolla e Gjelbër”, Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër “Mendime të Maskuara”

“Shfaqja trajton shëndetin mendor, si një ndër temat tabu e që nuk flitet thuajse fare në shkolla e familje. Përmes kësaj shfaqje tregojmë se me çfarë situata ballafaqohemi edhe ne si fëmijë apo adoleshentë, si ndihemi dhe çfarë kalon në mendjen tonë.”

7. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Asim Vokshi”, Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër “Rrjetet Sociale”

“Porosia e kësaj shfaqje është se rrjetet sociale janë ato të cilat e largojnë çdo individ nga realiteti ku jeton, duke na dhuruar një botë virtuale e cila na shkëput nga rrethi shoqëror e nga ai familjar. Thuajse të gjithë përdoruesit e rrjeteve sociale kanë pësuar fatin e të qenurit vetëm, larg familjes e larg të gjithëve, dhe që kanë hapur sytë e tyre me vonesë e kanë parë se bota virtuale i ka mashtruar tërë kohën me lojërat e saj duke shkatërruar nga pak gjendjen shpirtërore e atë sociale me realitetin. Pikërisht shfaqja e eventeve pasuese negative nga rrjetet sociale ka sjellë në jetën e përdoruesit të tyre antivlerën e antisocializimit.”

8. Klubi teatror i SHFMU “Enver Maloku”, Podujevë

Shfaqja forum teatër “Ditëlindja”

“Një udhëtim i anuluar për Prizren në ditëlindjen e Altinit do sjellë klasën para një situate të pakëndshme. Altini, personi më bullizues i klasës ndaj personave me probleme financiare, sot gjendet në situatën e njëjtë si personat që i ngacmonte deri dje. Ai është penduar për gjërat që ka bërë, por shoqëria e tij që e donin për të mirat materiale që Altini kishte, sot do e shohin ndryshe dhe nuk do ta pranojnë ndryshimin e tij e aq më pak që ta festojnë ditëlindjen e tij në praninë e pjesës së klasës që kanë probleme financiare.”

9. SHFMU “Xheladin Rekaliu”, Podujevë

Shfaqja forum teatër “Dua të jetoj”

“Pandemia, përveç situatës së rënduar dhe stresuese për ruajtjen e shëndetit ajo ka ndikuar edhe në rritjen e dhunës në familje, abuzimit me alkool. Në të njëjtën situatë gjendet familja e Jonës dhe Aleksit. Humbja e punës së babait të tyre dhe abuzimi me alkool ka filluar të shkatërrojë familjen. Fëmijët nuk kanë mundësi të vijojnë mësimin online. Edhe telefonin e dhuruar nga shoqja e Jonës, babai do e marrë që ta shesë për pije. Gjendja rëndohet me infektimin e Jonës me virus. Shfaqja trajton pandeminë dhe pasojat e saj në familje, rritjen e dhunës gjatë kohës kur familjet ishin të mbyllura.”

10. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU "Thimi Mitko", Gjilan

Shfaqja Forum Teatër "Baleti për të gjithë"

"Një nxënës i cili ka filluar të merret me orët e para të baletit, detyrohet të kontrollojë ushqimin për shkak të profesionit të dëshirës për t'u bërë balerin profesionist. Por, ai bie në depresion të thellë shkaku i presionit të madh për të humbur peshë dhe pasojat janë të paparashikueshme."

11. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU "Zija Shemsiu"', Gjilan

Shfaqja Forum Teatër "Çikat vs. Djemtë"

"Në një klasë ku djemt' janë të apasionuar pas futbollit, nisë një garë rastësisht e tyre me shoqet e klasës e cila shndërrohet në diçka shume interesante. Çikat të vendosura për të thyer barrierën e paragjykimeve gjinore përgatiten maksimalisht për t'i mundur djemt' që pretendojnë se futbolli është sport për burra dhe djemë."

12. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU "Emin Duraku", Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër "Hyrja C1, Kati 3"

"Koprracia ka qenë dhe do mbetet vesi më i keq i njerëzimit. Të kesh të mira materiale nuk do të thotë që i ke të gjitha. Në një lagje të Prishtinës, 2 familje shumë të ndryshme do vihen përballë njëra tjetrës në situata të ndryshme. Sa është e vlefshme pasuria në një familje kur nuk ekziston dashuria?!"

13. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Emin Duraku”, Shtime

Shfaqja Forum Teatër “Pa andërr”

“Një grup nxënësish të shkollës fillore marrin lajmin se do të organizohen ngjarje kulturore nga komuna me karakter garues. Ata i rreken punës fort për të marrë pjesë me shfaqje teatrore dhe këndim, por dikush tjetër iu prish ëndrrat. Për ta vendos dikush tjetër në mënyrë arbitrare dhe pa përfillur kritere në selektim. Nxënësit revoltohen dhe duan të reagojnë në këtë padrejtësi.”

14. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Abdullah Shabani”, Carralevë, Shtime

Shfaqja Forum Teatër “Korrupsioni”

“Meqë dita e shkollës afrohet edhe nxënësit po intensifikonin provat për t’u shfaqur sa më mirë në programin për ditën e shkollës. Mirëpo, rrjedha ndryshon kur ata kuptojnë që sërish programin do ta moderojë i njëjti nxënës nga vitet e kaluara, për të cilin ata janë skeptik që do e di ta bëjë më të mirën. Gjithashtu ata dyshojnë në aferë korruptive tek kujdestari i klasës nga prindi i moderatorit të njëjtë të caktuar disa vite radhazi.”

15. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Pavarësia”, Siboc, Podujevë

Shfaqja Forum Teatër “KODI?!”

“Në një klasë arsimtarja e lëndës së gjuhës shqipe fillon të paragjykojë vajzat e asaj klase për veshjet dhe sjelljet e tyre, përderisa ajo i mbështeste djemtë. Arsimtarja së bashku me drejtorin vendosin që ta përpilojnë një rregullore vetëm për vajza. Kjo e pengon kujdestaren e klasës e cila i përkrahë nxënëset.”

16. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Nazim Gafurri”, Prishtinë

Shfaqja Forum Teatër “Zëri brenda meje”

“Shtypësi dhe i shtypuri kanë zëra në kokë të cilët i bëjnë ata të veprojnë në mënyra të ndryshme. Shfaqja trajton diskriminimin që e bën arsimtarja në mes të dy nxënësve, djalit të drejtorit dhe një nxënësi tjetër, e duke e bërë këtë ajo i motivon nxënësit që ti bëjnë bullizëm e ta përqeshin. Por jo të gjithë shkojnë me “rrymën” e keqe të të tjerëve, janë edhe disa që reagojnë dhe mundohen ta ndihmojnë shokun e tyre.”

17. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Selman Riza”, Gjakovë

Shfaqja Forum Teatër “Balerinë e Gangsterë”

“Edhe pse ndajnë një klasë të përbashkët, nxënësit janë të ndarë në dy grupe, balerinë e gangsterë. Përplasja e tyre ashpërsohet kur të dy grupet do të vihen përballë njëri-tjetrit në një garë vallëzimi, fituesi i të cilit do të siguronte një udhëtim në Brezovicë. Por, çfarë ndodhë me këto dy grupe në ditën e garës, a do të përcaktojë fituesin sjellja e tyre në skenë?!”

18. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Zef Lush Marku”, Brekoc, Gjakovë

Shfaqja Forum Teatër “Ditëlindje me copëza dëshpërimi”

“Një vajzë e ndrojtur e ka ditëlindjen. Shoqet e saj e organizojnë festën e ditëlindjes duke marrë çdo gjë nën kontrollë. Kjo festë prishet me ardhjen e dy shokëve të saj të cilët nuk preferohen nga vajzat.”

19. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Zekeria Rexha”, Gjakovë

Shfaqja Forum Teatër “Sukses pas një dështimi”

“Një nxënës i talentuar që dëshiron të bëhet kitarist, e ka një kitare të vjetër e të prishur. Në pamundësi për ta blerë një të re ai e gjen një mënyrë për të fituar para, të dalë në qytet dhe të bëjë muzikë në rrugë me kitarën e tij të vjetër. Por, disa bashkëmoshatarë e përqeshin dhe nuk e lënë rehat në punën e tij.”

20. Klubi Teatror i shkollës kampione SHFMU “Emin Duraku”, Gjakovë

Shfaqja Forum Teatër “Si ti, jam edhe unë”

“Në klasën 9/3 një grup nxënësish planifikojnë të dalin në mbrëmje. Në këtë klasë janë Andi dhe Fiona, të cilët janë motër e vëlla. Fiona është vajza e cila gjithmonë duhet të rrijë në shtëpi, derisa vëllai i saj nuk ka asnjë obligim dhe është i lirë të dalë sa herë të dojë. Kur e gjithë klasa dalin përfshirë dhe Andin, Fiona e dëshpëruar tej mase pas një zënke me prindërit ku nuk e pati mbështetjen e tyre, vendos të largohet nga shtëpia, në shenjë revolte për të gjitha padrejtësitë që po i bëhen. Ajo gjen ngushëllim tek shoqja saj Lea, dhe shkon tek shtëpia e saj në orët e vona të natës...”

5. Festivali i Teatrit për të Rinj/Reja // Edicioni i 9-të // 10.12.2021 – 12.12.2021

Edhe këtë vit, sikurse në vitin 2020, për shkak të situatës pandemike me Covid-19, edicioni i 9-të i Festivalit të Teatrit për të Rinj dhe të Reja u mbajt online, 10-12 dhjetor, 2021. Përmes platformës www.teatriri.com dedikuar për prezantimin e shfaqjeve forum teatër dhe faqes së Facebook "Travelling Theater for Children and Youth" publiku ka mundur t'i shikojë dhe vlerësojë këto shfaqje të klubeve teatrore të 20 shkollave kampione.

E veçanta e këtij edicioni, për dallim nga viti i kaluar ku kishim video drama të performuara dhe xhiruara online, edicioni i 9-të vjen me performancë reale të nxënësve fizikisht para publikut por të xhiruara që më pastaj janë prezantuar online para një audience edhe më të gjerë.

Duke qenë se Festivali kishte karakter garues, përzgjedhja e shfaqjeve fituese është bërë përmes votimit të jurisë dhe publikut. Nga data 10.12.2021 – 12.12.2021, juria dhe publiku kanë votuar e vlerësuar këto shfaqje, duke nxjerrë katër shfaqjet fituese, të cilat ishin shpallur më 14 dhjetor, 2021.

Çmimet për tre vendet e para janë dhënë nga juria profesionale në përbërje të: Anisa Ismaili - aktore, Visar Krusha - dramaturg dhe Dardan Kryeziu - psikolog. Derisa Çmimi i Publikut u përzgjedh online nga publiku/audienca virtuale e Faceebook-ut duke klikuar videon e preferuar në faqen: Travelling Theater for Children and Youth, prej datës 10.12.2021 deri më 12.12.2021. në ora 24:00.

Vendi I - Shfaqja Forum Teatër: "Mendime të Maskuara" - SHFMU "Shkolla e Gjelbër", Prishtinë,

Vendi II - Shfaqja Forum Teatër: "Ekspozita" - SHFMU "Xhemail Mustafa", Prishtinë,

Vendi III - Shfaqja Forum Teatër: "Çikat vs. Djemtë" - SHFMU "Zija Shemsiu", Gjilan,

Vendi III - Shfaqja Forum Teatër: "Kodi?!" - SHFMU "Pavarësia", Siboc-Podujevë

Çmimi i Publikut: Shfaqja Forum Teatër "Rrjetet sociale" nga SHFMU "Asim Vokshi", Prishtinë

Përshtypjet personale të palëve bashkëpunuese

“Përmes aktiviteteve tona teatrale ne kemi mundësuar zhvillimin e të menduarit kritik, bashkëpunimin në mes nxënësve, mësuesve dhe artistëve dhe shkëmbimin e përvojave të nxënësve nga vendet rurale, urbane dhe komunitetet e ndryshme”

Drejtoresha artistike e shfaqjeve forum teatër dhe e festivalit, Zana Hoxha

Eksperienca me nxënësit më ka pasuruar në shumë drejtime: më ka ndihmuar të eksploroj artin nëpërmjet botës së tyre, më ka dhënë mundësi të kuptoj ndikimin që ne e kemi në komunitet, më ka rritur profesionalisht duke më përmbushur edhe në anën shpirtërore.

Daniela Markaj, aktore – mentore e klubeve teatrore

“Gjithmonë kënaqësi të punosh me gjeneratat e fillores, mësimi është i ndërsjellë. Vëmendje të veçantë duhet kushtuar gjithmonë kësaj pjese të shoqërisë, vetëm atëherë do të jemi të sigurtë.”

Kushtrim Qerimi, aktor – mentor i klubeve teatrore

“Një shok i vërtetë ballafaqimi me kaq shumë talente të cilët në pavetëdije presin për udhërrëfim dhe shfaqje të vetes së tyre. E gjithë kjo eksperiencë na vë para një përgjegjësie shumë të madhe që ka të bëjë me edukimin e duhur dhe vazhdimin e punës me këta fëmijë që as vetë ata nuk janë të vetëdijshëm për cilësitë dhe talentet e tyre. E gjithë kjo eksperiencë që ndodhi duke iu falënderuar Artpolis-it sot më bën shumë krenar që sadopak arrita që të kontribuoj në zhvillimin e këtyre fëmijëve dhe klubeve teatrore të krijuara nga Artpolis.”

Armend Zeqiri, aktor – mentor i klubeve teatrore

“Jam ndier shumë mirë gjatë punës me nxënës. Ata/ato ishin shumë të kënaqur me punën time si trajnere dhe mentorë e klubit dhe me punën e plotë të Artpolis. Kjo u vu re nga kërkesa e nxënësve por edhe e mësimdhënësve për të vazhduar sërish me projekte të tilla. Pas përfundimit të trajnimit (performancës) studentët kanë fituar vetëbesim dhe njohuri, liri në skenë dhe në jetën e përditshme.”

Qendresa Kajtazi, aktore – mentore e klubeve teatrore

Interesimi shumë i madh i fëmijëve për me krijua shfaqje teatrale, më ka dhënë motiv me punua me ta, me mësua prej sinqeritetit te tyre dhe me shiju punën.

Edlir Gashi, aktor – mentor i klubeve teatrore

Procesi i krijimit të shfaqjeve forum teatër me katër shkollat fillore në Gjakovë ishte sfidë, por mbi të gjitha kënaqësi e jashtëzakonshme. Kjo ishte një përvojë që s'do të harrohet, e që na ka shërbyer për të mësuar nga njëri-tjetri, për të fuqizuar njëri-tjetrin që të japim mesazhe sa më të fuqishme përmes temave të trajtuara në shfaqje.

Flamur Ahmeti, aktor – mentor i klubeve teatrore

Për mua puna si trajner me studentët ishte një përvojë shumë e mirë dhe interesante. Prova në ditën e parë në shkollën fillore "Dr. Ibrahim Rugova" ishte shumë emocionuese, sidomos takimi me studentët dhe njohja me ta nga afër. Ne vazhduam provat me një koordinim shumë të mirë; çdo provë ishte diçka e re për mua. Nxënësit kishin një vullnet të madh për punë që në fund realizuam një shfaqje e cila u prit shumë mirë nga publiku. Fëmijët më dhanë shumë dashuri.

Armend Ballazhi, aktor – mentor i klubeve teatrore

"Puna ime me nxenes ne punetorine dramaturgjike te Art'polisit ishte nje pervoje e kandshme dhe ne te njejten kohe sfiduese. Me duhej te gjeja menyra origjinale komunikimi me nxenes qw per nje kohe te shkurte te nxitja, pos kurreshtjes, edhe prirjet e tyre meshehura ne sfiden e shkrimit tw drames. Rezultatet ishin inkurajuese..."

Prof. Fadil Hysaj, trajner për dramaturgji - regjisor, dramaturg

---

"Jam i fascinuar me punën e madhe që e kanë bërë shkollat në programin ArtEd të ARTPOLIS, me vullnetin dhe aftësinë e nxënësve për të krijuar shfaqje teatrore dhe me temat që i kanë trajtuar. Forum teatri është një mënyrë e mirë për të rinjtë për ta mësuar teatrin dhe për të reflektuar për botën që i rrethon dhe Festivali i Teatrit për të Rinj/Reja – edicioni i nëntë, dëshmoi se këta të rinj e kanë përmbushur këtë mision me sukses. I përgëzoj të gjithë nxënësit pjesëmarrës dhe ARTPOLIS për punën e bërë në forum teatër!"

Visar Krusha, trajner për dramaturgji dhe juri në festival – regjisor, shkrimtar, dramaturg

---

E lumtur që kam arritë ti shoh të 20 shfaqjet nga nxënësit e klubeve teatrore nga shkollat e Kosovës. Është privilegj për mua me i pa këta artistë të rinjë, në ardhje. Ata janë frymëzim për gjeneratat e reja. Iu dëshiroj suksese edhe më tutje.



Anisa Ismaili, juri në festival - aktore, gazetare

Aktivitetet që Artpolis po i zhvillon me të reja e të ri më japin kënaqësi të veçantë. Këto aktivitetet kanë përfshirë shumë shkolla nga qytete e fshatra të ndryshme duke sjellë diversitet. Periudha e pandemisë për të rinjtë ka qenë sfiduese dhe stresuese, andaj përmes teatrit përveç talentit të tyre te rinjtë kanë shprehur edhe brengat dhe shqetësimet e tyre, si dhe kanë dhënë mesazhe të mira për shoqërinë. Është kënaqësi e veçantë për mua kur e shohë këtë sukses të Artpolis të arritur në gjithë Kosovën.

Dardan Kryeziu, juri në festival - psikolog

“Kampi artistik me nxënësit e shkollave fillore ishte një eksperiencë interesante dhe motivuese. Aty kam pasur mundësinë që ta shpalosi anën time humane si dhe njohuritë ndër personale me qëllim që të depërtoj pozitivisht tek gjeneratat e reja. Me qasje dhe mendje të hapur, kam arritur që ta shoh jetën nga perspektivat e llojllojshme të nxënësve.”

Zhaneta Xhemajli, trajnere në kampin artistik - aktore

“Ishte hera e parë për mua, ishte një përvoje e paharruar me ata fëmijë të dashur e të sinqertë dhe që nuk kishte vdekur dashuria për teatrin tek këta fëmijë krahas teknologjisë së avancuar që është.”

Ismail Kasumi, trajner në kampin artistik - aktor

“Bashkëpunimi me Artpolis ishte diçka e veçantë që ndodhi në shkollën tonë. Si shkollë kampione, nën përkujdesjen e Artpolisit u formua klubi i teatrit me gjithsej 16 nxënës dhe 3 koordinatore mësimdhënëse. Artpolis ka sjellë argëtim, rekreacion, plotë humor e shumë dashuri për nxënësit tanë. I mrekullueshëm, pozitiv, edukativ dhe plot pasion për punë ishte bashkëpunimi me Artpolis. Shpresoj që do vazhdojmë një projekt të tillë për krijimin e shfaqjeve teatrore.”
Pleurat Rudi, drejtor i SHFMU “Zekeria Rexha”

“Puna me organizatën Artpolis ka qenë njëra ndër eksperiencat me të bukura që ne si shkollë kemi pasur, përveç kënaqësisë ne kemi fituar edhe shumë njohuri rreth krijimit te teatrit brenda shkollës, të cilat me shumë siguri do ti praktikojmë në shkollën tonë. Ju falënderojmë shumë per profesionalizmin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe. “
Gresa Rrahmani, mësimdhënëse në SHFMU “Xhemail Mustafa”, Prishtinë

Punë, lodhje, prova për diçka të suksesshme. Argëtim, lojë, të qeshura e momente shumë të bukura.
Yll Pllana, nxënës në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”, Obiliq

Falënderimet janë prej më të mëdha që na u dha mundësia ti shprehim talentet tona edhe në artin teatror. Ishte eksperiencë shumë e veçantë. Mësuam fjalë të reja, iu përçuam mesazh moshatarëve se si ta ngrenë zërin e tyre kur është e nevojshme. Zbuluam shumë talente në shkollën tonë, morëm këshilla profesionale kështu me radhë. Faleminderit shumë Artpolisit për mundësimin e kësaj eksperience të pa harruar.
Rona Llugaliu, nxënëse në SHFMU “Xheladin Rekaliu”, Podujevë

Stafi i përfshirë në projekt

“Ishte kënaqësi dhe një ndjenjë e veçantë që isha pjesë e këtij projekti; themelimi i klubeve, më pastaj ngritja e kapaciteteve të po të njëjtave, për mua ka qenë një udhëtim i paharruar. Ndryshimet pozitive tek nxënësit më kanë inspiruar që angazhimi im me klubet të jetë i pa kompromis. Ndërkaq, aktivitetet e shumta më kanë mundësuar që krahas drejtorëve, mësimdhënësve dhe artistëve, të zhvillojmë bashkëpunime edhe me institucionet lokale kulturore, që kanë dhënë një rezultat të mahnitshëm. Ndërveprimet e tilla me palët bashkëpunuese, më kanë dhënë përmbushje sa profesionale aq edhe emocionale.” -

Venera Ismaili, menaxhere e projektit

“Puna me nxënësit/et e klubeve teatrore të 20 shkollave fillore kampione ishte kënaqësi e veçantë. Përveçse sfidë, ishte një përvojë që më ka bërë të rritem në aspektin profesional, shpirtëror e njerëzor. Më ka bërë të kuptoj kompleksitetin e punës me fëmijë, por edhe të marrë e të mësoj nga entuziazmi e energjia e tyre e pashtershme. Shoqëria jonë ka në gjirin e saj oaza të pashtershme talentesh, të cilët/at janë në pritje të zbulimit e zhvillimit për të korrur suksese në jetë”,

Berat Bajrami, asistent i projektit.

Berat Bajrami, Venera Ismaili, Valëza Sijarina, Donarta Limanaj, Elira Lluka

Mediat

TV SYRI
https://www.youtube.com/watch?v=jlMwrriBCwU

RTK “AVENTURAT TONA 13.11.2021”
https://bit.ly/3EB3xNy

Koha.net // Artistic camp for beginner actors // https://bit.ly/3A8OiIP // https://bit.ly/3xsXaHn

Rtv Dukagjini // 4-day camp for beginner actors // https://bit.ly/3CjpJuS

KultPlus // Art camp with 20 students of Theater Clubs and the artistic troupe of Artpolis in the village of Kukaj // https://bit.ly/3lwlRkc

Falënderime

“ArtEd –Fuqizimi i 20 klubeve teatrore në shkollat kampione të Kosovës” është përkrahur nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane dhe i falënderojmë për mundësinë.

Prezantimi i shfaqjeve do të ishte i mangët pa një bashkëpunim të ngushtë me shkollat (drejtorët, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit), me artistët (regjisoren, aktorët/et, dramaturgët), jurinë, ekipin dizajnues, ekipin xhirues, stafin e Artpolis por edhe me institucionet kulturore, përfshirë këtu: Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, Qendra Rinore në Ortakoll të Prizrenit, Qendra Rinore “Social Hub” në Gjilan, Shtëpia e Kulturës në Shtime, Teatri i Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë dhe Teatri i Qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë.

STAR WARS

Art
22.06
22.12



HRLM

theatre
youth
fest

artpolis art and community center